



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1601 Prot

Tiranë, më 14.11.2019

V E N D I M

Nr.138, datë 14.11.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Kamëz, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit”, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil në këtë bashki.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Kamëz,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në shërbimin civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019 “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Kamëz.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Bashkia Kamëz, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me urdhrin nr. vendimin nr. 42, datë 03.01.2019, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kamëz”, strukturë e cila është në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas strukturës aktuale, Bashkia Kamëz së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **114** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **1** pozicioni i nivelit të lartë drejtues, **13** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, **19** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **81** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt u konstatuase vetëmnëpozicionin “Përgjegjës i Sektorit të IT”, në Drejtorinë e Transportit, Lejeve, Liçensimit dhe IT, ishte punësuar Hane Nika, me aktin e përkohshëm të emërimit nr. 414, datë 19.08.2019.

Në lidhje me këtë rast, evidentohet se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Kamëz, ka publikuar shpalljen e procedurës së konkurrimit nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, për praninë nga jashtë, për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të IT”, duke bërë shpalljen pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit me shkresën nr. 5219 prot., datë 12.09.2019, e ndërkaq procesi i konkurrimit është kryer, në përfundim të të cilit kandidatja Hane Nika është shpallur fituese dhe me aktin nr. 1/4, datë 21.10.2019, të njësisë përgjegjëse është emëruar nëpunës civil në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të IT”, në Drejtorinë e Transportit, Lejeve, Liçensimit dhe IT, në Bashkinë Kamëz.

Me kryerjen e kësaj procedure, konkludohet se, në Bashkinë Kamëz të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil janë plotësuar me punonjës të emëruar rregullisht, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ndërsa **18** pozicione pune të shërbimit civil, rezultojnë vende të lira, për të cilat janë marrë të gjitha masat për plotësimin e tyre nëpërmjet procedurës së konkurrimit.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se, nga ana e institucionit të Bashkisë Kamëz, është vepruar në përputhje me ligjin gjatë administrimit të shërbimit civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i

Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të përmbillet procesi i inspektimit të kryer në Bashkinë Kamëz, pasi nuk janë evidentuar parregullsi gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil nga ana e njësisë përgjegjëse dhe e subjekteve të tjera të ngarkuara me detyra të veçanta për administrimin e shërbimit civil, në këtë institucion.
2. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Kamëz, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Kamëz, si dhe Ministria e Brendshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha